



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KOLONJE**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Ersekë, më . 02.2021

**Lënda:** Dërgohet Raporti për Minitorimin e Buxhetit për Vitin 2020

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE .

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit",nr.3 TIRANE

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarte të Monitorim të Buxhetit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore" bashkëlidhur po ju dërgon Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2020 me anekset përkatëse për Bashkinë Kolonjë.

KRYETARI

Erion ISAI

# **BASHKIA KOLONJË**

## **RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2020**

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore" neni 48, "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 date 30.07.2018 "Per procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore", i paraqitim Grupit për Menaxhim dhe Strategji në Bashki "Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2020.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2020 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr. 13912015 "Për veteqeverisjen vendore"*
- *Ligjin nr. 9632 date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar*
- *Ligjin nr. 68 /2017" Për financat e vetqeverisjes vendore"*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 88 /2019 Për buxhetin e vitit 2020".*
- *Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 date 20.03.2018. "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 114 datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2020".*

Raporti i monitorimit të buxhetit paraqet punën e administratës së Bashkisë Kolonjë dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara në Buxhetin afatmesëm 2020-2022 i miratuar nga Këshilli i Bashkisë si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësive të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit.

Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Kolonjë për periudhën 12-mujore është realizuar duke zbatuar me korektesi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit 2020 kryesisht kjo e diktuar nga situatë e pandemisë COVID 2019.

### **MISIONI I BASHKISË KOLONJË**

1. Misioni i këtij buxheti për Bashkinë Kolonjë është gjithpërfshirës, i paanshëm, perceptues, transparent, dhe është hartuar dhe mbështetur në ligj, për sigurimin e një qeverisje të efektshme, efikase, në një nivel sa më afër komunitetit nëpërmjet :
  - Njohjes së vlerave të bashkisë
  - Zgjidhjes dhe ofrimit të llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave të tjera publike në dobi të komunitetit
  - Ushtrimin efektiv të funksioneve ,kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e veteqeverisjes vendore.
  - Realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme , bazuar në nevojat e komunitetit

- Realizimin e shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative .

## OBJEKTIVAT E BASHKISË KOLONJË PËR VITIN 2020

- ❖ Zhvillimi ekonomik i qytetit Erseke , Leskovik dhe Njësive Administrative
- ❖ Zhillimi i agro turizmit dhe i turizmit
- ❖ Nxitja e punësimit dhe sipërmarjes në agroturizëm
- ❖ Ofrimi i shërbimeve cilësore
- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale
- ❖ Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes
- ❖ Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive, në veçanti të sportit të moshave dhe ekipeve zinxhir.
- ❖ Rehabilitim i objekteve arsimore ,administrative,sociale
- ❖ Projektet strategjike

Raporti vjetor i monitorimit përmban :

Aneksi nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve";

Aneksi nr.2 "Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetore";

Aneksi nr.3 "Raporti i realizimit te produkteve te programit";

Aneksi nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te programit";

Aneksi nr.5 "Raporti i investimeve me financim te brendshem";

"Pasqyra e treguesve financiare"

Buxheti i Bashkisë Kolonjë funksionon me 25 programe buxhetore si më poshtë:

1. 01110 Planifikim ,menaxhim dhe administrim
2. 01120 Ceshtje finaciare dhe fiskale
3. 03140 Sherbimet policore vendore
4. 04220 Sherbimet bujqesore, ispektim ushqimi e mbrotje
5. 05320 Programet e mbrojtjes se mjedisit
6. 06140 Planifikimi urban
7. 10140 Ndhma ekonomike
8. 10430 Kujdesi social per femije
9. 05100 Manaxhimi I mbetjeve
10. 06260 Sherbimet publike
11. 06440 Ndricimi I rrugve
12. 10220 Sigurim shoqeror
13. 04240 Menaxhimi I infrastuktures se uit dhe kullimit.
14. 04260 Administrimi I pyjeve dhe kullotave
15. 04520 Rrjeti rrugor rural
16. 09120 Arsimi para shkollor dhe arsimi baze
17. 09230 Arsimi I mesem dhe i pergjitheshem
18. 03280 Sherbimet e mbrojtjes nga zjarri
19. 01170 Gjendja civile

- 20. 04130 QKB
- 21. 08130 Sptri dhe Argetim
- 22. 08220 Trashegimi kulturore evnimnte artistike dhe kulture

Për gjatë vitit 2020 nga Këshilli i Bashkisë janë marrë vendime keshilli duke filluar nga miratimi i buxhetit shtesë për të ardhurat e trasheguara nga vitit 2019, alokime fondesh, vendime për përdorim të fondit të emergjencave ,fondit rezervë dhe të kontigjencës kryesisht për të përballuar emergjencat e krijuara nga gjendja e pandemisë COVID 2019 e cila u menaxhua në mënyrën më të mirë të mundëshme nga grupet e patronazhimit të ngritura me punonjësit e Bashkisë Kolonjë si dhe përballimin e disinfektimit të të gjithë ambjenteteve të shkollave dhe kopshteve të bashkisë sonë si dhe të gjitha ambjentet e zyrave të punonjësve , ambjentet e jashtëme ,hapësirat publike , shkallët e pallateve etj.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr. 1 "*Raporti i shpenzimeve sipas programeve*" për periudhën vjetore 2020. A). Shpenzimet faktike në fund të vitit janë realizuar në shumën 713.587. mijë lekë, plani i buxhetit për vitin 2020 është 799.723. mijë lekë ,( sipas situacionit të shpenzimeve të kuadruar me degën e Thesarit Kolonjë , plani fillestar i buxhetit pa fërfshirë investimet e çelura nga Ministrinë përkatëse ishte 287.674 mijë lekë , plan buxheti vjetor 2020 ,296.418 mijë lekë,buxheti i rishikuar i viti + shtesat ishte 368.939 mijë dhe realizimi faktik i tij 299.452 mijë lekë. Shtesat e buxhetit vitit 2020 janë kryesisht nga

- a) Shtesa fondesh nga buxheti i shetit për transferta në buxhete familjare&individe apo investime;
- b) Shtesa të transfertës së pakushtëzuar nga qeveria për përballimin e situatës COVID 19.
- c) Çelje fondi për ndihme për familjet e dëmtuara nga tërmeti .
- d) Shpërblimet për fëmijët e lindur në vitet 15-16.
- e) Investimet e çelura nga qeveria për bashkinë Kolonjë.
- f) Celje e fondit të tatimit të thjeshtuar e cila l takonte bashkisë sonë.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 sipas aneksit nr 1 parqiten si më poshtë:

Sipas planit vjetor progresiv planifikuar shpenzime 799.723 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 713.587mijë lekë, i shprehur në % kjo shifër është realizuar në masën 89.23 % ose me nje mos realizim ne masen 86.136 mijë lekë.

Referuar ANEKSIT 2 "*Raporti i shpenzimeve te programeve sipas artikujve*", jep shpenzimet te grupuara sipas artikujve per te gjithë programet,duke bere krahasimin ndermjet dy periudhave fakti 2018 dhe fakti 2019 kemi nje ulje te shpenzimeve ne masen 23%, per vitin 2018 realizuar buxheti ne masen 559.199 mije leke per vitin 2019 ralizuar 428.131 mije leke ose 131.068 miije leke,, por krahasuar me planin vjetor progresiv realizimi i shpenzimeve eshte 83.6 % ose – 83459 mije qe vjen nga:

- a) Mosrealizimi i te ardhurave te planifikuara ne shumen 34.811 leke
- b) Mosrealizimi i shpenzimeve te planifikuara ne shumen 48.648 leke.

- 1. Mosrealizimi i shpenzimeve korente si rezultat i kursimit të shpenzimeve në zërin"Paga shumën -12.449 mijë lekë vjen për arsye të mosplotesimit të strukturës të miratuar në fillim të vitit ku numri i planifikuar ka qene 285 punonjes dhe ne fakt në fund të vitit 243
- 2. Për Sig Shoqerore - 3.467 mijë lekë,
- 3. Shpenzime mallra e shërbime -28.556 etj

4. Mos realizimi i investimeve në shumën – 63.469 mijë leke ka ardhur si rezultat i uljes së vleres limit të objekteve në tender ,nga mos realizimi i investimeve të planifikuara nga të ardhurat.

Shpenzimet sipas programeve paraqiten si më poshtë:

### **Programi 01110 "Planifikim ,menaxhim dhe administrim"**

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithëshme për personelin

Sherbime të përgjithëshme për publikun , si shërbimet e prokurimit , mbajtja dhe ruajtja e dokumentave dhe arkivave të njësisë , ndërtesat në pronësi apo të zëna nga njësi ,zyrat e IT .

Administrim ,funktionim dhe afrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë së vetqeverisjes vendore ,për këshillin ose komisionet e këshillit .

Shërbimet statistikore dhe bazat e të dhënave vendore

Prodhim dhe përhapje e informacionit publik ,dokumentacionit teknik dhe statistikave për cështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit .

#### **Qëllim**

Qeverisje vendore e përgjegjeshme dhe administratë transparente

Përmirësimi i kapaciteteve të bashkisë për ritjen e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit .

#### **Objektivat**

1. Të rritet qëndrueshmërisë në administratën civile .
2. Përmirësimi i stafit të bashkisë .

#### **Prokukti**

Punonjës të kualifikuar dhe staf transparent.

#### **Treguesit e performancës**

- Ritja e qëndrueshmërisë së administratës civile që ka të bëjë me nr e punonjësve që lëvizin brenda vitit në krahasim me nr total të punonjësve .
- Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë që ka të bëjë me masat disiplinore të mara nga stafi i bashkisë.
- Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit

#### **Realizimi i treguesve të performancës**

- Nr i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit në krahasim me nr total të tyre është **30%** më l vogel se viti 2019.
- Masat disiplinore të vendosura nr 5 ose 28.5 % më pak se viti 2019.
- Nr punonjësve të trajnuar për vitin 2020 është 35 nga 30 të planifikuar ose 116.67 %
- Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit u realizua nëpërmjet rikonstruksionit të godinës dhe zyrave të punonjësve me kushte komode, paisjen me ngrohje qendrore , me rjet internet me shpejtësi të lartë,me paisje zyre të reja .

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program .

a. Referuar ANEKSIT të shpenzimeve në programi 01110 vihet re se shpenzimet në total janë planifikuar në masën 49.191 mijë dhe janë realizuar në masën 43.629 mijë ose 88.69 % me një diferencë prej 5.562 mijë .

b .Në zërin paga dhe sigurime shoqërore kemi mosrealizim të shpenzimeve,kjo për arsye se numri i punonjesve i miratuar në fillim të vitit është l paplotësuar ,planifikuar page 21.148 mijë lekë ,fakti në fund të vitit është **31** punonjës me një fond page të periudhës progresive në shumën 19.718 mijë lekë dhe me realizim faktik në shumën 17.659 mijë lekë e shprehur 89.56 %.

Realizimi i shpenzimeve për sigurime shoqërore në fund të vitit është 83.72 % krahesuar me planin progresiv të buxhetit, ose më pak 575 mijë lekë.

c. *Shpenzimet Operative*, në këtë zë kemi realizim të shpenzimeve kundrejt planit progresiv nga 21.592 mijë lekë është realizuar 18.999 mijë lekë ose 87.99% , pra kemi një mos realizim në krasim me planin në shumën prej 2.593 mijë lekë. Ky mosrealizim vjen kryesisht nga mosrealizimi i të ardhurave të veta .

Në totalin e shpenzimeve % më të madhe e zënë shpenzimet për të zgjedhurit në shumën 2.422 mijë lekë ose 16.73 %, vendime gjyqësore në shumën 2.500 mijë lekë ose 13.16% energji 1.569 mijë lekë ose 8.26%, material pastrami e shërbimi në shumën 2.506 mijë ose 13.19%, karburant + vaj + pjesë këmbimi shumën prej 2.560 mijë ose 13.47%.

d. Shpenzime kapitale planifikuar në shumën 4.160 mijë realizuar në shumën 3.825 mijë ose 91.95 % kryesisht Rikonstruksion i pjeshëm I çatisë së godinës së bashkisë, sistemi dixhital (kamerat).

### **PROGRAMI 1120 . Ceshtjet finacaire dhe fiskale.**

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i borxhit dhe funksionim i skemave të taksimit;
- Bashkerendimi me degen e thesarit , zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave dhe auditi i brendshëm.
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
- Planifikimi i përgjithshëm dhe shërbimet statistikore, duke përfshirë formulimin, bashkërendimin dhe monitorimin.

### **Qëllimi**

Të rriten kapacitetet financiare për të mbështetur shërbimet ndaj komunitetit .

### **Objektivat**

Përmirësimi i financave të bashkisë nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave të planifikuara nga taksat dhe tarifatat vendore , duke punuar për uljen e informalitetit e cila con në ritjen e numurit të subjekteve të liçensuara .

Menaxhimi me efektivitet I të gjitha burimeve financiare duke ulur detyrimet e prapambetura të pa paguara.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Mbyllja e bilancit vjetor më një bilanc të drejtë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të dalë jo negative .
- ✓ Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave të veta dhe ritja e të ardhurave nga menaxhimi i aseteve të bashkisë .

Me gjithë punën e bërë për realizimin e të ardhurave si në drejtim të luftës për uljen e evazionit fiskal dhe ndjekjen e arketimit të detyrime, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2020 janë realizuar në masën 69.50 % ose nga 80.050 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 55.627 mijë lekë,

Ky tregues sipas struktures se të ardhurave parqitet si me poshte;

Nga taksat vendore të ardhurat janë realizuar në masen 102.9 % ose nga 16.677 mijë lekë të ardhura janë realizuar 17.162 mijë lekë .

Nga tarifatat vendore të ardhurat janë realizuar në masën 64.6 % ose nga 58.391 mijë lekë të ardhura janë realizuar 37.695 mijë lekë.(shif pasqyren e të ardhurave bashkalidhur ).Duhet theksuar se një ndikim të madh në realizimin e treguesve të të ardhurave janë mos realizimi i të ardhurave nga drutë e zjarrit ku për vitin 2020 ky tregues është realizuar në masën 14.9 % . duke marrë parasysh dhe kushtet e vështira të viti 2020 krijuar nga situatë COVID 19.

Lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2020 në bashkinë tonë I është dhënë prioritet likuidimit të tyre . Për vitin 2020 detyrimet e prapambetura kapin shumën 12.182 mijë lek ku rreth 67.87% të tyre e zënë vendimet gjyqësore të cilat panvaresisht se paraqiten si detyrime të viteve të kaluara bashkia

planifikoi buxhet për vitin 2021 për likuidimin e rreth 81.39 % e detyrimeve totale dhe pjesa e mbetur prej 18.61 % do të paguhet në vitin 2022, detyrimet e mbetura për vitin 2022 janë vetëm detyrime për vendime gjyqësore.

Shpenzimet për këtë program janë planifikuar për të realizuar detyrat e programit ku sipas aneksit të programit 01120 paraqiten si më poshtë:

- a. Shpenzimet në total për këtë program janë planifikuar sipas planit buxhetor progresiv 15.879 mijë lekë dhe janë realizuar sipas faktit të vitit 2020 në shumën 13.967 mijë lekë me një diferencë prej 1.912 mijë ose në % janë realizuar në masën 87.96 %.
- b. Pagat janë realizuar në masën 94.11 % me diferencë prej -594 mijë, ndërsa sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 90.63 % ose me një mos realizim në shumën 167 mijë lekë.
- c. Shpenzimeve operative për këtë program janë planifikuar sipas planit të periudhës progresive 3.979 mijë lekë dhe janë realizuar 2.828 mijë lekë ose 71.07%.  
Peshen më të madhe në këto shpenzime e zënë shpenzimet për shpërbimin e kyepleqve 602 mijë lekë, karburant dhe vaj 916 mijë lekë, kancelari 850 mijë lekë, diferencat tjetër e zënë shpenzimet për ,telefoni , ujë , postare ,dieta, mirmbajtje mjete etj.

### **Programi 03140 “ Sherbimet Policore**

Sigurim, i mbrojtjes ,qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike Brenda territorit të njësisë në përputhje me dispozitat ligjore.

Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari dhe vendimet e këshillit bashkiak .

#### **Qëllimi**

#### **Përmirësimi i sigurisë së komunitetit**

#### **Objektivat**

*Ritja e cilësisë së shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet duke rritur nr e trajnimeve për punonjësit e policisë bashkiake me të paktën 3 trajnime në vit .*

Parandalimi me masa mbrojtëse të të gjithave problematikave që kanë të bëjnë me rendin,qetësinë,pronën dhe cdo competence tjetër të pushtetit lokal.

Mbulimi i të gjithë territorit të bashkisë me punonjes të policisë bashkiake

Ritje e rasteve të manaxhuara nga ana e policies bashkiake duke rritur dhe bashkëpunimin me policimë e rendit .

#### **Produkti**

Punonjës policie të trajnuar,nr raste konfliktesh të menaxhuara .

#### **Treguesit performance**

- ✓ *Ulja e nr të rasteve problematikë në komunitet*
- ✓ *Ritja e nivelit të kualifikimit*
- ✓ *Ruajtja e qetësisë publike , locale për zhurmat*

Realizimi i treguesve të performancës.

1. Nr rastesh të raportuara nga popullata tek policia bashkiake 65
2. Raste të menaxhuara nga policia bashkiake 60
3. Kontrollë të ushtruara nga policia bashkiake 70
4. Kontrollë të ushtruara në bashkëpunim me policine e Shtetit 6
5. Zbatim vendimesh të ndryshme 40
6. Menaxhim aktivitetesh kulturore e sportive të ndryshme 49

Zgjidhja e konflikteve për problem të ndryshme të qytetarve si në drejtim të pronësisë,garatimi i sigursë së pronës dhe asaj publike, ushtruar kontrollë në subjekte të ndryshe ,kontrollë në bashkëpunim me institucionete e tjera si I MT , pyjore, tatim taksa ,zbatimin të vendime gjyqësore -prokurori , dhe shërbimet e ndryshme në qytet , treg , transport etj.

**Për realizimin e treguesve të performancës nga sherbimi policor në vitin 2020 treguesit e shpenzime të këtij program paraqiten si më poshtë :**

- a. Shpenzimet totale për këtë program sipas planit të periudhes progresive dhe aneksit përketes planifikuar shpenzimet totale 6.395 mijë lekë realizuar 5.715 mijë lekë tëo se 89.37 %.
- b. Pagat plan 5.273 mijë lekë , realizuar 4.908 mijë lekë ose 93.08 %
- c. Sigurimet planifikuar 822 mijë lekë realizuar 807 mijë lekë ose 98.18 %
- d. Shpenzimet korenët planifikuar 300 mijë lekë, realizuar 0 mijë lekë

**Programi 03280** 'Mbrojtja nga zjarri dhe shërbimet civile “

### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

Funksionimi i njësive zjarfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit .

Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, evakuimi i zonave të përmbytura etj. Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimeve dhe mbrojtjes kunder zjarrit .

### **Qëllimi**

Përmirësimi i sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit ,

### **Ojektivat**

Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe **shpëtimit nëpërmjet uljes së rasteve problematike ,reagim më të shpejtë ndaj njoftimeve për zjarrin ,përmirësimi të shërbimit të parandalimit të zjarrit duke ulur me numurin e rasteve të menazhusra .**

### **Produkti**

**Numuri i rasteve të menaxhuara , koha e daljes nga stacioni , numuri i inspektimeve tek të tretët (privat dhe publik).**

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Reagimi më I shpejtë ndaj njoftimeve për zjarret , me ndryshim sekondash të daljes nag stacioni
- ✓ Nr i stacioneve të MZSH
- ✓ Nr i inspektimeve dhe vizitave tëk të tretët

Realizimi I treguesve të performancës

1. Nr stacionesh të MZSH
2. Nr inspektimesh të kryera lidhur me rreziqet e zjareve 115
3. Nr I rasteve të menaxhuar 65
4. Çertifikata të sigurisë së zjarrit 6
5. Aktivitete shërbimi 350

### **Referuar ANEKSIT !shpenzimeve për programin 3280**

Sektor i MZSH operon ,me fonde nga tranferta sektoriale , 13.935 mijë lekë , realizuar në shumën 12.857 mijë lekë ose 92.26 % .

-Shpenzimet totale për këtë program sipas planit të periudhës progresive dhe aneksit përketes paraqiten si më poshtë :

- a. Shpenzimet totale të planifikuara 13.935 mijë lekë ,realizuar 13.935 mijë lekë ose 92.26 %
- b. Pagat plan 9.746 mijë lekë, realizuar 9.633 mijë ose98.84 %
- c. Sigurimet planifikuar 1.629 mijë lekë, realizuar 1.622 mijë lekë ose 99.57%
- d. Shpenzimet korenët planifikuar 2.560 mijë lekë, realizuar 1.602 mijë lekë ose 63.36 % kryesisht janë karburant 830 mijë lekë ,goma bateri 180 mijë lekë ,si dhe siguracion jete në shumën 350 mijë lekë ,siguracione mjetesh 99 mijë lekë.

**Programi 04220 “ Sherbimi bujqësor ,ispektimi dhe siguria ushqimore.**

### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë,



përmasat dhe pronësinë e parcelave.

Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore.

Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore dhe kategorive të tjera resurse .

Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë.

Kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorëve .

### **Qëllimi**

Rritja e produkteve bujqësore dhe blegtorale ,mbrojtja e tokës bujqësore nga gryerjet dhe përmbytjet ,si dhe rritja e sigurisë ushqimore .

### **Objektivat**

1. Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet rritjes së numurit të inspektimeve dhe kontroleve në teren si dhe zgjidhjes së konflikteve pronësore me 95 raste për vitin 2020,
2. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmbytjet duke bërë 3 prita malore në vitin 2020 e cila mbron rreth 120 ha tokë,

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Rritja e sigurisë së konsumatorëve
- ✓ Nr i rasteve të gjetura nga inspektorën në tegun bujqësor dhe blegtoral
- ✓ Nr i certifikatave të pronësisë të regjistruara .
- ✓ Nr i parcelave të mbjella me bimë .
- ✓ Nr i pritave për mbrojtjen e tokës

### **Realizimi i treguesve të performancës.**

- Raste inspektimi të kontrollit ushqimor 1700
- Konsultim me publikun, këshillim me fermerët e teritorit të bashkisë dhe saktësim pronësie 80
- Numur certifikatash të pronësisë dërguar në ASHK Kolonjë 252
- Dhënie tokash me qera 4
- Nr pritash të ndërtuara për mbrojtjen e tokës nga përmbytjet 3 nga 5 ml secila ,konkretisht 1 në fshatin Starje në parcelat e bërdishtës, 2 copë në lumin e fshatit Taç Poshtë ( këto dy prita dhanë shumë rezultat në përmbytjet e ndodhura në muajin janar 2021).
- Sipërfaqe toke bujqësore të mbrojtura 230 ha

Në mbështetje të rritjes së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale është rritur numuri i inspektimeve për minimizimin e sëmundjeve dhe infeksioneve të prodhimeve bujqësore që çojnë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Zgjidhjen e konflikteve të pronësisë lidhur me saktësimin e pronave për vitin 2020 janë saktësuar konflikte me pronësinë, janë regjistruar certifikat pronësie dhe janë marrë masa për mbrojtjen e tokës nga gryerjet e lumenjve duke ngritur srate në ato vende ku rrezikohet përmbytja. Jane kryer inspektime në raste lidhur me kontrollin ushqimor në funksion të ruajtjes së sigurisë ushqimore.

Për përmbushjen e detyrave funksionale dhe realizimin e treguesve të performancës për këtë strukturë janë planifikuar fondet si më poshtë :

- a. Buxheti vjetor i rishikuar planifikuar 4.689 mijë dhe realizuar 3.903 mijë ose 83.24 %
  - b. Fondi I pagës I planifikuar 3.428 mijë ,realizuar 3.025 mijë ose 88.24 %
  - c. Fondi për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore planifikuar 723 mijë ,realizuar 512 mijë ose 70.82 %
  - d. Fondi për shpenzime operative planifikuar 88 mijë ,realizuar 32 mijë ose 36.36 %
  - e. Fondi për shpenzime kapitale planifikuar 450 mijë ,realizuar 334 mijë ose 74.22 %
- Fondi I pagës I pa realizuar si rezultat I nr faktik më i vogël se ai I planifikuar I cili ndikon dhe më mosrealizimin e fondit të sigurimeve shoqërore.Fondi i investime konkretish realizimi I 3 pritave nga procedura e tenderimit .

## **04240 "Menaxhimi infrastruktures ujitje kullimit"**

1. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve , të ujitjes dhe\_kullimit , duke përfshirë grandet për punime të tilla
2. Administrim ,shfrytësim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit nën përgjegjesinë e njësive të vetqeverisjes vendore .

### **Qëllimi**

Të përmirësojë shërbimin e ujitjes dhe kullimit nëpërmjet pastrimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve dhe ujëmbledhësave me synim rritjen e prodhimeve bujqësore dhe mbrojtjen nga përmbytjet , duke pastruar 80 km kanal ujitës dhe 54.5 km kanal kullues e cila do të përmirësojë kullimin në 450 ha tokë bujqësore

### **Ojektivat .**

1. Përmirësimi I sistemit të ujitjes duke pastruar 27.2 km kanal ujitës për vitin 2020 e cila do të përmirësoje ujitjen ne një sip prej 825 ha toke .
2. Përmirësimi I sistemit të kullimit duke pastruar 7.8 km kanal kullues për vitin 2020 e cila do të përmirësoje aftësinë kulluese ne një sip prej 150 ha toke .
3. Të pastrohen dhe zhblokohen 3 ujëmbledhësa për vitin 2020 duke shtuar sip ujitëse me 30 ha ,
4. Të bëhet rehabilitimi i kanaleve ujitëse në Selenice dhe Kozel më veshje beton në 3 km për vitin 2020.
5. Të rehabilitohen 44 vepra marje uji ( sfrate ) për cdo vit , për ujitjen e 550 ha tokë bujqësore.
6. Ngritja e poligonit që do prodhojë elementëve të parapërgatiturme në kohë dhe në cilësi në veprat inxhinierike .

### **PRODUKTI**

Kanale kullues dhe ujitës të parstruar te rehabilituar , funksionalë e cila u shërben shtimit të sipërfaqeve të ujitura dhe të kulluara , lëndë e parë cilësore për rehabilitime kanalesh .

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Ritja e sipërfaqes të mbuluar me ujitje
- ✓ Ritja e sipërfaqes të mbuluar me kullim
- ✓ Ritja e nr të familjeve përfituese
- ✓ Lekë të shpenzuar për 1 km kanal

### **Realizmi i treguesve të performancës**

- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Gjonç me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Taç qëndër me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Ersekë – Taç poshtë me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Kagjinas me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Barmash me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Rezervuari helmës -Qafzes me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Kozel me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Shtikë me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Kabash -Leskovik me punëtorët e bashkisë

- Punime në pastrimin e kanalit ujitës Qnam me punëtorët e bashkisë
- Punime në pastrimin e kanalieve të II-ta ujitëse në Qafzes me fadromë
- Punime në pastrimin e kanalieve të II-ta ujitëse në Mollas me fadromë
- Punime në pastrimin e kanalieve të II-ta ujitëse në Prodan-Taç Qëndër –Borovë-Kodras me fadromë
- Pastrim në kanalën Ujitës Kabash – Ersekë me eskavatorin e madh me zinxhirë.
- Pastrim në kanalën Kullues në vendin nën lokalën Helmës
- Rehabilitim i 44 veprave të marjes së ujit në të gjitha njësitë Administrative me fadromë.
- Pastrim ,transport inertesh dhe rrethim i rezervuarit të Kodrasit.
- Sip e përmirësuar nga kullimi 90 ha.
- Gjatësi kanalesh kullues të pasturaur 4.7 km
- Sip e përmirësuar me ujitje 850 ha
- Gjatësi kanalesh ujitëse të pastruar 51 km
- Mirëmbajtje e shkarkuesve katastrofikë nr 5
- Mirëmbajtja e kanaleve furnizues të rezervuarëve nr 3
- Është realizuar blerje e një ruli i cili shërben për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore të parcelatave të fermerëve pas pastrimit të kanaleve ujitëse dhe kulluese.
- Rikonstruksion i kanalit të Kabashit Leskovik (investim në vazhdim)
- Rikostruksion i kanalit të Gjonçit Ersekë ( investim në dy vite 2020-2021)

Për realizimin e detyrave për menaxhimin e ujitjes dhe kullimit sipas programit 04240 për vitin 2020, terçuesit e shpenzimeve të këtij programi paraqiten si më poshtë :

- a. Shpenzimet totale 44.057 mijë lekë në plan dhe realizuar 39.095 mijë lekë ose 88.74 %
- b. Fondi i pagave planifikuar 3.829 mijë lekë dhe realizuar 3.547 mijë ose 92.64 %
- c. Fondi i sigurimeve shoqërore në plan 640 mijë dhe realizuar 585 mijë ose 91.41 %
- d. Fondi i shpenzimeve operative 9.620 mijë lekë në plan dhe realizuar 8.805 mijë ose 91.53 % ku 61.21 % e zë tërë shpenzime për mirëmbajtje, 29.57 % karburant dhe vaj 7.3 shpenzime për mirëmbajtje mjete dhe pjesa tjetër shpenzime ngrohje,kancelari energji ,ujë, dieta.
- e. *Shpenzimet kapitale kapin shumën në plan 4.026 mijë lekë dhe në fakt 1.514 mijë ose 37.61 % mosrealizimi procedura prokurii të pa zhvilluara.Këto fonde janë nga transferimi i pakushtëzuar.*
- f. *Shpenzime kapitale me financime të brendëshme nga qeveria janë në plan 25.942 mijë dhe realizuar 24.644 mijë ose 95 % për dy objekte .1. Rikonstruksion i kanalit të Kabashit Leskovik (investim i filluar në vitin 2019),2. Rikostruksion i kanalit të Gjonçit Ersekë ( investim në dy vite 2020-2021)*

### **04260 "Programi pyje e kullota"**

1. Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
2. Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i
3. rezervave pyjore
4. Administrimi i fondit pyjor dhe kullor .
5. Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe
6. dhënie e licencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve);
7. Organizimi ose mbështetja për veprimtari ripyllëzuese , kontrollet e dëmtuesve dhe sëmundjeve , shërbimi pyjor për luftën kundër zjarrit dhe parandalimin e tij si dhe afrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë
8. Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;

9. Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes
10. Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra, mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë.

### **Qëllimi**

Të sigurojë përdorim të qëndueshëm në pyje e kullota , duke ritur të ardhurat në pyje e kullota ,ritjen e nr të inspektimeve të fondit pyjor e kullosor si dhe përmirësimi ifondit pyjor e kullosor .

### **Objektivat**

1. Ritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat nëpërmjet hartimit të planit të mbarështimit 10 vjeçarë e cila do të sigurojë dru zjari për popullatën për 19.000 banorë në një sasi prej 8000 ms në një sip prej 1000 ha për vitin 2020 e cila do të sjellë dhe ritjen e të ardhurave me mesatarish 5.000 mijë .
2. Të risë nr e kontrolleve dhe inspektimeve në teren me nga 10 në cdo vit për të shmangur dëmtimet në fondin pyjor .
3. Të ndërtohen 2 lera në cdo vit buxhetor të cilat do ju shërbejnë 5000 krerëve në vitin 2020,

### **Produkti**

1. Sigurojmë dru zjari për popullatën ,si dhe rritim të ardhurat e bashkisë nga shitja e tyre , do të minimizohen dëmtimet e pyjeve dhe kullotave dhe do të përfitojme lera dhe korrita për të pirë ujë blegtoria në zota ku do të kullosin

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Ritja e të ardhurave nga sektori pyjor dhe kullosor
- ✓ Planet e menaxhimit të fondit pyjor
- ✓ Ritja e inspektimeve të fondit pyjor e kullosor

### **Realizimi i trguesve të performancës .**

- ✓ Eshtë realizuar Hartimi I planit të mbarështimit 10 vjeçar 1
- ✓ Janë realizuar kontrolle dhe inspektime në pyje 680
- ✓ Janë ndërtuar lera dhe korrita për blegtorinë 2 copë

### **Referuar ANEKSIT !**

*Për realizimin e këtij programi shpenzimet sipas planit progresiv për vitin 2020 janë realizuar si me poshte.*

- a. *Planifikuar shpenzime totale 25.270 mijë lekë dhe janë realizuar 13.641 mijë lekë*
- b. *Paga të planifikuar 8.184 mijë lekë realizuar 7.777 mijë lekë ose 95.03 %*
- c. *Sigurimet shoqerore janë planifikuar në masën 1.420 mijë lekë, janë realizuar në masën 1.298 mijë lekë ose 91.41 %.*
- d. *Shpenzimet operative janë realizuar në masën 2.797 mijë lekë nga 13.305 mijë lekë të janë planifikuar ose 10.67 %.Në këtë mosrealizim ka influencuar mos realizimi i shitjes së druve të zjarrit për popullatë ku të ardhurat nga tarifa e druve të zjarrit janë 3.387 mijë lekë nga 22.786 mijë lekë të planifikuar ose 14.9 %, ky mosrealizim ka ndikim dhe në mosrealizimin e shpenzimeve.*
- e. *Shpenzimet kapitale janë shpenzimet për hartimin e planit të mbarështimit ,ndërim lera e korrita për blegtorinë si dhe shtigje turistike . Planifikuar 2.361 mijë dhe realizuar 1.769 mijë ose 74.93 %, zëri shtigje turistike i pa realizuar .*

## **04520 Rjeti rrugor rural**

Vështrim i përgjithshëm i programit

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit, rrugë, ura

Studime për rehabilitimin, përmirësimin e rrjetit rrugor në administrimin e njësisë vendore.

### **Qëllimi**

Zhvillimi social dhe ekonomik nga komunikimi ndërurban, sigurimi i aksesit rrugor për të gjitha njësitë administrative të saj të shërbimit bazik (qendra shëndetsore dhe shkollat publike)

### **Ojektivat**

1. Zgjerimi i rrjetit rrugor në dy njësi administrative, Qëndër Erseke dhe Mollas me 10 Km për vitin 2020.
2. Mirëmbajtje dhe rehabilitim i rrjetit rrugor rrural në të gjitha njësitë administrative në 200 km nga 238 që është totali.
3. Mbajtja në gadishmeri e 139 km rrugë rurale të cilat bllokohen nga rreshjet e bëborës në stinën e dimrit.

### **Produkti**

Rruge të mirëmbajtura, funksionale dhe në shërbim të komunitetit.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Përmirësimi i rrjetit rrugor rrural dhe urban duke mbajtur km rrugë vendore funksionale
- ✓ Zgjerime të rrjetit rrugor rrural
- ✓ Përmirësimi i sigurisë rrugore

### **Realizimi i treguesve këto punime janë kryer me mjetet dhe punonjësit e sektorit të rrugëve rurale.**

- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Prodan – Gjonç km 5
- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Rehovë – Shën Pjetër km 1
- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Ersekë -Mësiçkë km 8
- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Mësiçkë –Kabash km 4
- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Ersekë – Gostivisht km 5
- Zgjerim, çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugën rurale Lixhat Leskovik km 7
- Hapje rrugë e re në fshatin Kaduç-Polenë km 7
- Mbajtja e 139 km rrugë rurale në gadishmëri duke bërë zhblokime nga dëborat në stinën e dimrit.
- Riparim dhe kthim në gjendje pune të pacarelës që lidh fshatin Dokollarë-Taç Poshtë km 2

*Referuar ANEKSIT!*

*Shpenzimeve për programin 04520 për mirëmbajtjen e rrugëve rurale shpenzimet në total progresivet janë planifikuar në shumën 10.862 mijë dhe të realizuara 8.348 mijë ose 76.86 %.*

*Fond page I planifikuar 4.694 mijë lekë dhe realizuar 4.229 ose 90.10%*

*Fond për sigurimet shoqërore 789 mijë në plan, realizuar 708 ose 89.73%*

*Shpenzime operative në plan 3.382 mijë, realizuar 3.381 mijë lekë ose 99.97 %*

*Shpenzime për investime në plan 1.967 mijë lekë në fakt 0 e perealizuar, nuk u realizua procedura e prokurimit (fond i cili u trashëguar për vitin 2021).*

## **04760. Zhvillimi i turizmi .**

Administrimi i çështjeve dhe turizmit vendor, Promovimi dhe zhillimi I turizmit vendor. Funksionimi I zyrave turistike vendore, organizimi I fushatave publicitare duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese/ Permiresimi I hapësirave pamore, urbane te Bashkisë dhe mirembajtjen e objekteve kulturore turistike që nxisin rritjen e vizitoreve duke I kthyer ato ne atraksione turistike te njesise vendore.

### **Qellimi**

Rritja e ekonomise vendore përmes turizmit malor, historik, kulturor natyror, kulinar etj Permiresimi I shërbimit të promovimit te turizmit Duke qene se eshte viti I pare krijimi I zyres per promovimin e Kolonjes do te duhet te fillohet pothuajse nga e para. Qëllimi është qe te kemi vizitorë sa me te orientuar per vëndet apo objektet (monumente kulture dhe natyre) që do të duhet të vizitojnë apo ku mund të marrin shërbimin e ushqimit apo fjetjes (restorante apo hotele). Nje qellim tjeter eshte evidentimi dhe promovimi I vlerat e trashëgimise kulturore te folklorit, dhe ruajtjes se traditave te zones Shtimi I numrit të të vetepunesuarve në agroturizëm

### **Objektiva**

1. Vendosja e 5 tabelave informuese per vizitorët në zonën e Kolonjës, guida informuese e Kolonjës me informacion për natyrën , monumentet kulturore dhe natyre , njesitë e shërbimit te zonës, fletëpalosjeve , hartave, banerave, posterave me të dhëna informuese për Kolonjën e cila do të shërbejë rreth 1000 vizitorëve duke sjellë rritjen e të ardhurave në njesitë e shërbimit të hoteleri-turizmit me rreth 30% per vitin 2020, dhe me rritje rreth 500 vizitorë për vitin 2021, 2022.
2. Promovimi I vlerave te trashëgimisë kulturore te folklorit, dhe ruajtjes së traditave te zonës, promovimi I prodhimeve artizanale , gastronomisë etj cka do sjellë zhvillimin e artizanatit dhe rritjen e numrit te vetpunesuarve në këtë fushë e cila do te sjellë shërbim më te mirë të vizitorëve te zonës.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Përmirësimi I klimës vendore për turizëm
- ✓ Përmirësimi I shërbimit në sektorin e turizmit
- ✓ Përmirësimi I shërbimit të promovimit të turizmit me nr turistësh , sistem zyre informacioni , nr turistësh që marin informacion

### **Realizimi I treguesve të performancës**

- ✓ Nr turistësh të akomoduar 220
- ✓ Nr turishtësh që marin informacion 1200
- ✓ Nr biznesesh të reja me drejtim agrobiznes që mbështeten me subvencionim të sigurimeve shoqërore 1.

### ***Referuar ANEKSIT!***

*Shpenzimeve për programin 04760 për turizmin shpenzimet në total progresivet janë planifikuar në shumën 7.548 mijë dhe të realizuara 2.664 mijë ose 35.29 % .*

*Fond page I planifikuar 3.986 mijë lekë dhe realizuar 2.274 ose 57.05%*

*Fond për sigurimet shoqërore 832 mijë në plan ,realizuar 708 ose 37.98%*

*Shpenzime operative në plan 2.730 mijë ,realizuar 3.381 mijë lekë ose 2.71 %*

*Kjo ishte strukturë e re e hapur në vitin 2020 , e pa plotësuar me nr punonjësish .*

## **Programi 05100 “Manaxhimi I mbetjeve “**

Administrim ,mbikqyrje ,inspektim organizim dhe mbështetje e sistemit të grumbullimit dhe eliminimit të mbetjeve .

Mbledhja ,largimi dhe trajtimi I mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake .

Pastrami I rrugëve , parqe, lulishte etj.

### **Qëllimi**

Të përmirësojë menaxhimin e metjeve bashkiake nëpërmjet trajtimit të tyre dhe sensibilizimit të komunitetit lidhur me problematikat që vijnë prej tyre.

### **Objektivat**

- Të shtohet nr i koshave metalikë të mbeturinave me 30 copë për vitin 2020,
- Të rritet numuri i fshatrve që pastrohen me 4 fshatra duke e cuar nga 11 në 15 nr e fshatrave të pastruar , e cila do tu shërbejë rreth 300 banorëve të këtyre fshatrave për vitin 2020 .
- Të rritet largimi i mbetjeve në ton me nga 10 ton në cdo vit ., ose nga 100 në 110 në vitin 2020.
- Të rriten nr I largimit të mbeturina ne ditë nga 1 në 2 herë në ditë në qytet dhe 1 herë në javë në fshat .
- Të rehabilitojmë venddepozitimet aktuale në qytetin Ersekë dhe Leskovik për vitin 2020.

### **Produkti**

***Përfitojmë 30 kosha të rinj ,të përdorshëm ,funktionale .shtim të ton mbeturinave të larguara ,ritet nr I fshatrave të pastruar , rit të ardhurat nga tarifa e pastrimit .***

### **Treguesit e performancës**

- ✓ **Mbulimi I të gjithë teritorit të bashkisë me menaxhim të mbetjeve** bashkiake
- ✓ Rritja e mbulimit me shërbime
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së shërbimit
- ✓ Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve
- ✓ Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit .
- ✓ Shuam totale e arkëtuar nga tarifa

### **Realizimi I Treguesve të performancës**

- U rit nr i koshave të mbeturinave me 100 copë për vitin 2020 me financim nga fonder IPA 2.
- U shtua nr i fshatrave të pastruar me 21 fshatra nga 11 fshatra që pastroheshin në vitin 2019 u arit në 32 në vitin 2020 duke shtuar sipërfaqen që mbulohet me shërbim pastrami , si dhe u caktaun venddepozitimet e mbetjeve për fshatrat që nuk kanë kazane mbeturinash .
- Në 4 fshatra ku kalojnë limenitë janë bërë pastrime të mbeturinave dhe inerteve nga punonjësit e sektorit të pastrimit .
- Ton mbeturinash të përpunuara 108.35 ton me një total shpenzimesh 2.316 mijë lekë .
- Janë pastruar dhe mirëmbajtur të gjitha sipërfaqet e lulishteve të dy qyteteve Ersekë dhe Leskovik.
- Në periudhën e verës është realizuar largimi i mbeturinave në qytet 2 herë në ditë , duke bërë përmirësimin e cilësisë së shërbimit .

- Tarifa e pastrimit për të gjithë teritorin e bashkisë është mbledhur në masën 97.91% ose nga 6.810 mijë lekë të planifikuara ,realizuar 6.668 mijë lekë.

#### *Referuar ANEKSIT!*

*Shpenzimeve për programin 05100 për manaxhimin e mbetjeve në total janë planifikuar 20.836 mijë ,realizuar 20.158 mijë lekë ose 96.75 %*

*Fondi I pagave planifikuar 11.508 mijë lekë ,realizuar 11.237 mijë lekë ose 97.65 %*

*Fondi I sigurimeve shoqërore planifikuar 1.868 , realizuar 1.854 mijë lekë ose 99.25 %*

*Fondi I shpenzimeve 7.403 mijë lekë I planifikuar dhe realizuar 7.037 mijë lekë ose 94.71 %., në shpenzime kryesisht shpenzimet janë për detyrimet e KRËË për punimin e mbetjeve , shpenzime për karburant për makinat si dhe material pastrami për punonjësit (detergjente ,disifektantë ,doreza)*

#### **Programi 5320** Mbrojtja e Mjedisit

Mbrojtja e ajrit dhe e klimës ,mbrojtja e tokës dhe e ujërave nëntokësore  
Planifikimi , administrimi i zhvillimit të teritorit sipas ligjit .

#### **Qëllimi**

Përmirësimi i cilësisë së mjedisit,Përmirësimi i treguesve të monitorimit të mjedisit tokë; ajër; ujëra

#### **Objektivat**

1. Zvogëlimi dhe kontrolli ndotjes së mjedisit.
2. Përmirësimi i treguesve të monitorimit të mjedisit : tokë; ajër; ujëra
3. Përmirësimi i mbikëqyrjes dhe inspektimit të veprimtarive që ndosin mjedisin.
4. Shtimi i nr të kontrolleve për ndërtimet pa lejë , dhe kontrollet për lejet e ndërtimit të miratuara me 30 % në cdo vit , për vitet 2020

#### **Realizimi i objektivave**

1. Nr prishjesh te ndërtimeve 110 nga 30 në vitin 2019, u prishën barangat në lagjen nr 1 dhe 2, u sistemua sipërfaqja e tyre .
2. M3 inertesh të disiplinuar 138
3. Kontrolle teritori 90 nga 25 në vitin 2019
4. Verifikime dhe zgjidhje konfliktesh 40 nga 30 në vitin 2019

#### **Produkti**

Ndërtime të reja dhe rikonstruksione konform ligjit .

#### *Referuar ANEKSIT!*

*Shpenzimeve për programin 05320 për Mbrojtjen e mjedisit në total janë planifikuar 2.039 mijë ,realizuar 1.294 mijë lekë ose 63.46 %*

*Fondi i pagave planifikuar 1.661 mijë lekë ,realizuar 1.105 mijë lekë ose 66.53 % mosrealizimi mungesë në pësonel nga 3 të planifikuar në fakt 2 specialistë janë në këtë strukturë.*

*Fondi i sigurimeve shoqërore planifikuar 278mijë lekë , realizuar 184 mijë lekë ose 66.19 % shpjegimi si tek fondi i pagave.*

*Fondi i shpenzimeve 100 mijë lekë i planifikuar dhe realizuar 5 mijë lekë ose 5 shpenzime në këtë struktue janë planifikuar vetëm për levizjet e specialistëve .*



## **Programi 6140 Planifikimi Urban**

*Zhvillimin , përditësimin ,bashkërendimin dhe monitorimin e planit të zhvillimit urbanistik Lëshimi I lejave për ndërtimet e reja si dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësive të vetqeverisjes vendore .*

*Shpërndarja e informacionit public, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet e shërbimit dhe të strehimit*

*Sigurimi I trualit të nevojshëm për ndërtime banesash , ndërtim ose blerje dhe rimodelim I njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerës me nevoja të posacme .*

*Eliminimi I ndërtimeve të degraduara e lidhur me sigurimin e strehimit .*

*Planifikimi I përgjithëshëm duke përfshirë formulimin ,përditësimin ,bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të përgjithëshëm vendor dhe planeve të zhvillimit strategjik .*

### **Qëllimi**

*Zhvillimi I teritorit të bashkisë në saje të planifikimit më të mirë të infrastructures.*

### **Objektivat**

*1. zhvillimin e territorit sipas instrumentave ligjor:*

- Plani përgjithëshëm vendor*
- Planet e detajuara vendore*
- Planet sektoriale*

*2. Planifikimi i mirë i zhvillimit të teritorit **duke rritur të ardhurat e** arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me 1000 mijë lekë cdo vit ose legalizimi i rreth 25 shtëpivë në vit.*

### **Realizimi I objektivave**

- 1. Leje ndërtimi të miratuara /lejave të ndërtimit në total 97%*
- 2. Nr projektesh për zhvillimin e infrastrukturës lokale 16*
- 3. Shqyrtim ankesash 41*
- 4. Të ardhura të arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë 1.537 mijë ose 73.9 % e realizimit të vitit 2019.*

## **06260 Sherbimet publike vendore.**

Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si

- a. rekreacioni ,hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin ,
- b. Mbjellja e luleve ,shkureve dhe pemëve devorative të cilat shtojnë sipërfaqen e gjelbër
- c. Zëvendësimi itrotuareve të prishura me material cilësore që përmirëson hapësirat publike dhe rit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve .
- d. Ndërtimi , reabilitim dhe mirëmbajtje e varezave publike.
- e. Parqe ,lulishte dhe hapësirat e gjelbëra publike .

### **Qëllimi I programit**

Bashkia siguron zhvillim të planifikuar të komuniteteve të reja dhe atyre ekzistuese.

### **Objektivat e Programit**

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta nëpërmjet mbjelljes së luleve dhe pëmeve
- Shtimi i sipërfaqeve të sistemuara në fashtin Mollas
- Përmirësimi i infrastrukturës publike nëpërmjet rikonstruksioneve pjesore në nivel qyteti .
- Të Rehabilitojë dhe mirëmbajë varrezat publike në të gjitha njësitë administrative dhe të rritë sipërfaqeve e reja me 4250 m<sup>2</sup> për vitin 2020 në qytetin Ersekë .

### **Treguesit e performancës**

- Ritja e shërbimit për komunitetin
- Përmirësimi i planifikimit të komuniteteve të reja ose të rehabilituara
- Përmirësimi i administrimit të problematikave dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit , me tregues matës , nr e projekteve për komunitetin , nr i çështjeve të administruara dhe nr i shërbimeve të afuara për zhvillimin e komunitetit

### **Realizimi i treguesve të performancës**

Sipërfaqe të gjelbëruara të shtuara 5500 m<sup>2</sup>

Rikonstruksioni 1345 m<sup>2</sup> trotuare konkretisht trotuaret në rrugën e dytë ,përpara spitalit ,përpara supermarket “Petriti “ postës në gjithë gjatësinë e tij .

Shtrim dhe asfaltim i rrugës së dytë në 120 m<sup>2</sup>

Mirëmbajtje e 25500 m<sup>2</sup> sipërfaqe të varezave publike dhe atyre të dëshmorëve .

Janë mirëmbajtur të gjitha lulishtet e qytetit .

Shtim sipërfaqe të reja të varezave me 3150 m<sup>2</sup> me sistemime tereni,pastrim ,rrugica ndarëse në parcela u bë muri rrethues i tyre në një gjatësi prej 200 ml , u bë çezma jashtë varezave, u shtrua dhe u sistemua rruga jashtë tyre në një gjatësi prej 300 ml.

Mirëmbajtja e këmbanarës së kishës së Vodices si objekt Monument Kulture

### *Referuar ANEKSIT!*

*Shpenzimeve për programin 06260 për zhvillimin e komunitetit në total planin 59.298 mijë lekë ,jane realizuar 40.880 mijë lekë me një mos realizim prej 18.418 mijë ose 68.94 % .*

*Paga planifikur 12.628 mijë leke realizuar 12.088 mijë lekë ose 95.72 %*

*Sigurimet shoqërore 2.108 mijë lekë realizuar 2.012 mjë lekë ose 95.45 %*

*Shpenzimet operative janë realizua në masen 10.591 mijë lekë nga 13.794 mijë lekë te planit progresiv ose 76.78% .Peshen më të madhe në shpenzimet operative e zene mterjale dhe shërbime ndërtimi në shumen 5.719 ose 54 % , karbuarnt dhe vaj 3.570 mijë lekë ,pjesë këmbimi në Shumen 565 mijë lekë etj.*

*Planifikur investime për vitin 2020 në total 30.768 mijë lekë dhe realizuar 16.189 mijë lekë ose 52.62 % .Janë realizuar blerje materiali për asfaltimrrugësh në shumën 2.200 mijë lekë , Investime për Net Metering ( Ndricimi LED shtyllat tek rruga pali Prifti ) në shumën 5.555 mijë lekë ,Grenpoin Mob ( Koshat ) në shumën 5.369 mijë lekë , ,Mbikqyje në shumën 871 mijë ,Rikonstruksion trotuarësh 1.563 mijë , Rikonstruksion I rrugës “ Pali prifti në shumën 7.702 mijë, Rikualifikimi I qendrës Mollas me 800 mijë lekë dhe shtim sipërfaëe të gjelbëruar nuk u realizaun, investime të planifikuara nga të ardhurat e vetë bashkisë të cilat u arkëtuan në masën 69.5 %*

## **06440 Ndricim Rrugesh.**

- Administrim ,instalimin ,vënien në funksion , mirëmbajtjen ,përmirësimin e ndricimit të rrugëve dhe mjediseve publike.
- Zhvillimi dhe rregullimi I standarteve të ndricimit rrugor .

### **Qëllimi**

Të përmirësojë dhe mirëmbajë rrjetin e ndricimit ekzistues , të ritë nr e fshatravë të ndricuara me rrjetin rrugor në vitet 2020-2022.

### **Objektivat**

1. Të risim sipëfaqen e ndricimit duke shtuar me 5 fshatra të ndricuara në cdo vit buxhetor me ndricim rrugor , e cila do tu shërbejë një popullsie prej rreth 350 banorësh , ose nga 30 fshatra sot do të venë 35 në vitin 2020.
2. Të përmirësojë dhe te mirëmbajë rrjetine ndricimit rrugor , nëpërmjet zëvendësimit të llampave dhe shtimit të kokave të ndricimit , per cdo vit
3. Përmirësimi total i rrjetit të ndricimit të qytetit Ersekë nëpërmjet zëvendësimit të shtyllave dhe linjave të ndricimit me te reja dhe me ndicues LED I cili do të realizohet brenda vitit 2020 me fondet e IPA 2.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Për përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.
- ✓ Rritja e mbulimit të territorit me ndricim publik.
- ✓ Përmirësimi I mbulimit të kostove nga tarifat e shërbimit.

### **Realizimi i objektivave**

Shtimi I nr të fshatrave me ndricim rrugor nga 26 në vitin 2019 në 30 fshatra në vitin 2020  
Ml linjë për ndricim LED në qytet 560 I realizuar me fondte IPA 2020  
Riokonstrukcion linjash duke zëvendësuar kabllin e djegur , ndërimit koka ndricuesi në 3500 ml  
Zëvendësill llampash te djeguar në të gjithë teritorin e bashkisë 1285 llampa.

### *Referuar ANEKSIT!*

*Shpenzimet totale progresive planifikuar në shumën 8.045 mijë , realizuar në shumën7.455 mijë ose 92.67 %.*

*Fondi i pagave planifikuar 1.881 mijë , realizuar 1.711 mijë ose 90.96 %*

*Fondi i sigurimeve shoqërore planifikuar 314 mijë , realizuar 285 mijë ose 90.76 %*

*Fondi I shpenzimeve 5.850 mijë i planifikuar , realizuar 5.459 mijë ose 93.83 % , shpenzimet kryesisht 4.759 për ndricimin rrugor ose 87.18 % e shpenzimeve totale , si dhe material për ndricim në shumen 700 mijë lekë.*

## **Programi 09120 "Arsimi parashkollor"**

Përfshim shpenzimet për paga për mësuesit e kopshteve të femijëve dhe stafit mbështetës. Programet mësimorë për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve .

Furnizimi dhe mbështetja me ushqim të kopshteve .

Ndërtim dhe mirëmbajtje të strukturave shkollore.

Ndjekja dhe garantimi I aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për fëmijet e kopshteve dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare .

### **Qëllimi**

1. Organizimi i aktiviteteve argëtuese ,formuese,evidentimi I talenteve te reja në pikturë-vizatim , sport , muzikë ,letërsisë,i fëmijëve të arsimit parashkollor dhe të arsimit 9- vjecar , me qëllim miqësimin me njeritjetrin , largimin nga veset e këqia të brezit të ri ,rruajtjen dhe trashëgimin e traditave kulturore artistike ,me zhvillimin e 10 aktiviteteve me fëmijët e kopshteve dhe 10 aktivitete nga QKF në vitet 2020-2022.
2. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitet 2020

### **Objektivat**

1. Organizimi i 20 aktiviteteve me fëmijër e kopshteve dhe nxënësit e shkollave 9-vjecare , me pjesëmarrjen e 226 fëmijëve të 16 kopshteve ,duke promovuar nga 5-15 talente të reja për cdo aktivitet në cdo vit , duke e ritur nr e nxënësve të promovuar sipas talenteve me nga 3-5 nxënës cdo vit .
2. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitin 2020 për 957 nxënës dhe 158 mësues ,për rreth 19 shkolla dhe kopshte.

### **Produkti**

1. Aktivitete të bukura dhe edukative në përputhje me stadet e zhvillimit sipas standarteve te grupmoshave që fëmijet kane ,talente të reja në pikturë, letërsi , muzikë, sport .
2. Ambjente shkollore të bukura , funksionale , të pastra dhe të sigurta për zhvillimin e një procesi normal mësimor .

### **Realizimi i objektivave**

1. Janë organizuar nga fëmijët e kopshteve dhe të shkollave 9-vjeçare gjithësej 17 aktivitete me gjithë kushtet e vështira të krijuara nga situatë COVID 19.
2. Janë mirëmbajtur gjithësej 23 shkolla dhe kopshte në arsimin 9-vjeçar duke krijuar kushte optimal për zhvillimin e mësimit duke garantuar ngrohjen në të gjitha institucionet arsimore ,por dua të theksoj masat e mara nga bashkia jonë për përballimin e situatës së pandemisë duke disifektuar cdo javë të gjitha institucionet arsimore dhe pas çdo rasti që paraqitet me simptoma COVIDI është bërë disifektim .
3. Janë garantuar dhe paguar pagat për të gjithë mësuesit e arsimit parashkollor ,punonjësit e QKF si dhe të atyre mdihmës në arsimin 9-vjeçar.

Referuar ANEKSIT shpenzimet paraqiten si më poshtë :

Shpenzimet totale në planin progresiv janë 49.494 mijë lekë ,realizuar 44.299 mijë lekë ose 89.50 %.

Fondi I pagave planifikuar 26.754 mijë lekë ,realizuar 26.528 mijë ose 99.16 %.

Sigurimet shoqërore planifikuar 4.831 mijë lekë ,realizuar 4.435 mijë lekë ose 91.80 %.

Shpenzimet planifikuar në shumën 9.034 mijë lekë ,realizuar 6.663 mijë leke ose 73.75 %.

Shpenzimet e këtij program janë realizuar në shumë 2.136 mijë për naftë për

kaldajat,shpenzime për material të tjera ngrohje 1.345 mijë (dru zjari

,gaz,pelet),shpenzime për mirëmbajtje në shumën 803 mijë ,material pastrami 353

mijë,kancelar 365 mijë, dhe pjesa tjetër ,energji ,ujë , telefon ,duke theksuar sembi 56 %

e shpenzimeve të arsimit mbulohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.

Shpenzimet kapitale planifikuar në shumën 8.845 mijë lekë ,realizuar në shumën 6.643

mijë lekë ose 75.10 %. Investime për shkollën P.N.Luarasi Ersekë.

### **Programi 09230 "Arsimi I mesem dhe i pergjithshem"**

#### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

1. Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore të arsimit të mesëm të përgjithshëm
2. Shpenzimet për pagat për stafin mbështetës të arsimit parauniversitar
3. Administrim ,ushqim ,strehim dhe kujdes mjekësor për fëmijët që strehoen në konvikt.

#### **Qëllimi**

1. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitin 2020

### **Objektivat**

1. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitet 2020, për 240 nxënës dhe,për rreth 3 shkolla të mesme dhe 1 konvikt .
2. Sigurimi i ushqimit për nxënësit konviktorë , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare , sigurimi i ngrohjes dhe një infrastrukturë e domosdoshme për një jetetesë normale në konvikt.
3. Garantimi I pagave të punonjësve mbështetës në këtë arsim si dhe të gjithë punonjësve të konviktit Ersekë.

#### Realizmi i objektivave

1. Janë sigurua kushtet optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke mirëmbajtur e tyre ,garantuar ngrohjen në 4 institucione arsimore të arsimit të mesëm të përgjithëshëm ose në 3 shkolla të mesme dhe 1 konvikt .janë siguruar materialet e pastrimit për këto shkolla si dhe është bërë disinfektimi i tyre një herë në jave dhe pas çdo rasti COVID të konstatuar në institucionet arsimore.
2. Janë krijuar të gjitha kushtet e domosdoshmepër për nxënësit konviktorë ,është siguraur ushqimi i tyre , ngrohja , pastrami për rreth 23 nxënës në fund të vitit 2020.
3. Janë paguar të gjitha pagat e punonjësve mbështetës të arsimit të mesëm të përgjithëshëm dhe të të gjithë punonjësve të konviktit gjithësej 7 punonjës mbështetës dhe 7 punonjës të koniktit .

Referuar ANEKSTIT shpenzimet paraqiten si më poshtë :

Shpenzimet totale në planin progresiv janë 58.930 mijë lekë ,realizuar 55.681 mijë lekë ose 94.49 %.

Fondi i pagave planifikuar 7.492 mijë lekë ,realizuar 26.528 mijë ose 98.25 %.

Sigurimet shoqërore planifikuar 1.251 mijë lekë ,realizuar 1.229 mijë lekë ose 98.24 %.

Shpenzimet planifikuar në shumën 2.735 mijë lekë ,realizuar 2.011 mijë leke ose 73.53.

Në të cilat përfshihen shpenzimëet për ushqime në shumën 540 mijë lekë , 400 mijë lekë material pastrami ,material për ngrohje ,energji ,telefon ,ujë , mirëmbajtje .

Shpenzimet kapitale planifikuar në shumën 7.046 mijë lekë ,realizuar në shumën 6.694 mijë lekë ose 95 % , nga fondete bashkisë , rikonstruksion cerdhe planifikuar 3410 mijë lekë , realizuar 3.240 mijë lekë nga të ardhurat e veta dhe shkolla Leskovik planifikuar 3.636 mijë realizuar 3.454 mijë lekë. nga fondet e qeverisë për sjkollën P.N.Luarasi vazhdim nga viti 2019 planifikuar 40.406mijë lekë ,realizuar 38.386 mijë lekë .

### **01170 "Programi i gjendjes civile"**

Fonde të pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile , në njësitë e qeverisjes vendore .

#### **Qëllimi**

Sigurimi i hedhjes ,rruajtjes dhe ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile të shtetasve shqiptarë,të huaj dhe personave pa shtetësi me banim të përkohshëm apo të përherëshëm ne RSH.

#### **Objektivat**

1. Sigurimi efikas dhe eficient I shërbimeve të gjendjes civile , duke përmirësuar shërbimin dhe shkurtimi I kohës së marjes së shërbimit .
2. Ritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të prodhuara .

Realizimi I objektivave

Është përmirësuar i shërbimi dhe është siguruar shërbim efikas për komunitetin  
Është shkurtua shërbimi ndaj personit në 5 min / person .  
Janë prodhuar 7413 dokumenta dhe janë arkëtuar 569 mijë lekë nga gjendja civile .

Shpenzimet totale të programit 01170 të gjendjes civile janë në total të planifikuara 3.347 mijë leke dhe të realizuara 3.247 mijë lekë , nga këto 2.439 mijë fond page ,401 mijë sigurime shoqërore , 53 mijë shpenzime operative dhe 380 mijë shpenzime për shpërblim lindje për fëmijët e lindur në periudhën tetor /2015 deri qershor 2016.

### **10140: Kujdesi social**

10140. Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara  
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë ,personat me aftësi të kufizuara , gra , fëmijë ,gratë e dhunuara , viktimat e trafikimit , jetimët ,nënë apo prindër me shumë fëmijë .

Në këtë program janë parashikuar pagat e punonjësve të cilët punojnë për shërbimin social në nivel vendor për shtrest në nevojë, përsoneat me aftësi të kufizuara .

#### **Qëllim**

Sigurimi I fondeve të nevojëshme për pagesat e ndihmës ekonomike dhe personat më aftësi të kufizuara , dhe shpërndarja në kohë e tyre , plotësimi I dokumentacionit të domosdoshëm në kohë të shpejtë dhe me standarte.

#### **Objektivat**

1. Përfshirja në skemë e individëve të përcaktuar me ligj
2. Krijimi i fondeve për ti ndihmuar financiarisht.
3. Mbrojtja dhe sigurimi i përfituesit nga cdo lloj forme abuzimi
4. Rekrutimi i një stafi të kualifikuar
5. Rezultatet që synohen të arrihen
6. Shpërndarja në kohë paaftësisë dhe invalidët e punës nga bashkia

### **Realizimi i objektivave**

1. Numri I personave të mbështetur me pagesë invaliditeti 467 në fund të vitit
2. Numur familjesh të mbështetur me ndihmë ekonomike dhe asistencë sociale 302
3. Persona të mbështetur me pagesë paaftësie 331
4. Verifikim në familje përfituese të ndihmës ekonomike 604
5. Fondet për këto kategori janë 115.915 mijë lekë.

Shpenzimet totale të programit 10140 të gjendjes civile janë në total të planifikuara 6.249mijë lekë dhe të realizuara 4.492 mijë lekë , nga këto 3.844 mijë fond page ,648 mijë sigurime shoqërore .

### **10220 . Te moshuarit.**

Ky program konsiston ne ndihmen ne natyre per personat e moshuar, per te lehetsuar jeten e tyre te perditeshme per integrimin e tyre ne jeten shoqerore . Per te ndihmuar moshen e trete duke krijuar nje ambjet per sherbimin e tyre.

#### **Qëllimi**

Organizimin dhe mbështetjen me skema mbrojtëse dhe lehtësuese për moshat e treta.

#### **Objektivi**

Ofrimi i shërbinit optimal për moshat e treta duke u mundësuar falas cdo ditë pirjen e kafes , çait si dhe shfrytëzimin e kohës se lirë në mënyrë aktive .

### **Realizimi i objektivave**

Është ofruar shërbim për të moshuarit në ambjentet e krijuara për ta tek pallati I Kulturës Ersekë duke u shërbye kafe ,caj ,amareta falas nga fondet e bashkisë si dhe shfrytezohen ambjentet e

lokalit për kalimin e kohës së lirë në mënyrë aktive .Për vitin 2020 ky shërbim ka qenë i kufizuar I dikutuar nga kushtet e pandemisë COVID 19.

Shenzimet e këtij program janë në total planifikuar 636 mijë , realizuar 529 mijë , kryesisht fond page 453 mijë dhe fond sigurimesh sjoqërore 76 mijë lekë.

## **104 Familje dhe Femije .**

### **10430 Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët .**

*Aframi në para dhe në natyrë për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet dhe fëmijët ,ndërimi dhe administrimi I qendrave për afrimin e shërbimeve sociale vendore ,strehë dhe ushqim për fëmijët dhe gratë e dhunuara si strehë afatshkurtër , organizim ,administrim dhe mbështetje të skemave të mbrojtje shoqërore , dhe pagesa e specialistit që mbulon këtë program .*

### **Qëllimi**

Bashkia në harmoni me politikën kombëtare zhvillon programe dhe merr masa për minimizimin e rasteve të dhunës .

### **Objektivat**

1. Sistemi i kujdesit social të jetë efikas duke mundësuar të paktën 10 raste të dhunë në famille me paketa ushqimore ,post strehimit të përkohsem dhe menaxhimit te rasteve .
2. Menazhimi i ndihmave të mbledhur në mënyrë vullnetare dhe shpërndarja e tyre në familjet në nevojë, për fëmijët jetim ,për gratë e dhunuara dhe për gratë kryefamiljare .

### **Realizimi I objektivave**

- 1.** Nr rastesh gra të dhunuara të trajtuara 5
- 2.** Nr fëmijësh të trajtuar , si dhe trajtim të azilkërkuesve në Qendrën Sociale “ Motrat Qirjazi e cila u promovua në vitin 2020 si një investim I përbasjkët me UNICEF dhe bashkinë Kolonjë për rreth 8 azilkërkues .

Buxheti I këtij program për vitin 2020 ishtë në totalin progresiv I planifikuar 665 mijë dhe realizuar 604 mijë lekë , fond page plan 574 mije realizuar 513 mijë lekë , sigurimet shoqërore plan 81 mijë fakt 81 mijë lekë , shpen operative 10 mijë realizuar 10 mijë .

## **10661 Strehimi social**

Ky program parashikon perfitime në natyrë për të ndihmuar familjet që përballojnë koston e strehimit.

### **Qëllim**

Permiresimi i sherbimit te strehimit social nëpërmjet garantimit të pagesës së 50 % të kostos së strehimit për familjet të cilët kanë përfituar statusin e të pastehëve .

### **Objektivat**

1. Përmirësimi i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit,Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social duke ritur nr e trajtimeve me 10 familje në vitin 2020
2. Rrija e efiçences e mbështetjes se strehimit social nga bashkia

### **Realizimi I objektivave**

Numuri I familjeve që kanë përfituar bonus qiraje për vitin 2020 ka qene 15 familje nga të cilat 5 familje janë të dëmtua nga tërmeti I qershor 2019 dhe 10 familje të tjera përfituese sipas ligjit për të pastrehët.

Buxheti vjetor I planifikuar nga Bashkia Kolonjë është 500 mijë dhe realizuar 97 mijë pasi pjesa tjetër është paguar nga fondet e qeverisë të celura për bons qeraje në shumën 421 mijë lekë.

### **08130 Sport dhe argëtim**

Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive (fusha lojërash, korsi vrapimi, etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore (ekipin e të rriturve dhe ekipet zinxhir në veprimtari të sportive

#### **Qëllimi**

Të nxitë, të zhvillojë dhe të përhapë kulturën sportive nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesmarjes në aktivitete të ndryshme .

#### **Objektivat e Programit**

1. Arritja e pozicionit sa më të lartë të Klubit të Futbollit Gramozi
2. Shtimi i aktiviteteve sportive
3. Të rritet cilësia e prezantimit të ekipeve të futbollit.

#### **Qëllimi**

Bashkia mbështet organizimin e eventeve sportive dhe argëtuese në kampionatin e kategorise se dyte per ekipet e te rriturve dhe ekipet e moshave

#### **Objektivat**

1. Përmirësimi i shërbimeve të argëtimit dhe sportit për komuniteti vendor
2. Përmirësimi i hapësirave argëtuese dhe sportive
3. Rritja e mbështetjes për ekipet përfaqësuese të bashkisë në veprimtari të sportive;

#### **Realizimi I objektivave**

1. Nr I ndeshjeve të zhvilluara në vitin 2020 është 9 ( në kushtet e pandemisë dhe motit të keq nuk u realizua kalendari sportive I plotë ) nga 12 të planifikuara.
2. Nr I ekipeve zinxhir 4
3. Nr fëmijësh pjesëmarrës në këto ekipe 60

Shpenzimet totale të planifikuara në këtë program janë 6.891 mijë lekë ,realizuar 6.101 mijë lekë ose 88.54 %

Fondi I pagës plani 2.788 mijë lekë ,realizuar 2.428 mijë ose 87.09 %

Fondi I sigurimeve shoqërore plani 415 , realizimi 406 mijë lekë ose 97.83 %

Fondi për shpenzimet operative 3.688 mijë ,realizuar 3.267 mijë ose 88.58 %

Dieta sporti 775 mijë lekë , shpenzimet e udhëtimit dhe ato të trajnerëve 638 mijë . si dhe janë përballuar shpenzimet energji ujë etj,

### **08220 Eventet artistike dhe kulturore**

#### **Qëllim**



Organizime te aktiviteteve kulturore dhe artistike , duke mundësuar rritjen e jetës kulturore dhe artistike në komunitet .

Afrim I publikut drejt aktiviteteve kulturore ne fushën e muzikës dhe letërsisë me shtrirje përgjatë gjithë vitit

### **Objektivat .**

1. Zgjerimi I aktiviteteve dhe rritja e shikueshmërisë me rreth 30% të shfaqjeve artistike dhe të teatrit të kukullave, organizimi i aktiviteteve letrare me nxënës të shkollave 9-vjecare dhe shkollave të mesme të rrethit ne bashkepunim me Qendren Kulturore te Femijeve.
2. Organizimi I aktiviteteve në të gjithë zonën e Kolonjës, vlerësimi I figurave të shquara që kanë dhënë kontribut ne fushën e artit. Organizim dhe mbështetje për ngjarjet kulturore dhe historike

(koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.)

### **Realizimi i objektivave**

1. Nr shfaqesh kulturore për vitin 2020 8 të zhvilluara të mbështetura nga bashkia Kolonjë.
2. Premjerë e teatrit të kukullave të dhëna në të gjitha zonat e Kolonjës 1
3. Shfaqje muzikore të zhvilluara me artistë vendas 7

Buxheti I këtij program I planifikuar 7.173 mijë lekë I realizuar 5.695 mijë lekë ose 79.34 %

Fondi i pagave planifikuar 4.060 mijë lekë ,realizuar 3.604 mijë lekë ose 88.78 %

Fondi i sigurimeve plani 682 mijë , realizuar 666 mijë lekë ose 97.65 %

Fondi i shpenzimeve operative 2.431 mijë .realizuar 1.425 mijë ose 58.62 %, janë përballuar aktivitete , shpenzimet për onorare , shpenzime ujë, energji etj.

Të dhënat janë të gjitha të analizuara dhe në tabelat bashkalidhur .

### **ANEKSI 3**

Te dhenat e aneksit tre sipas te dhenave ne formularin perkates bashkengjitur.

Në këtë aneks janë të analizuar shpenzimet me nr punonjësish , me artikuj dhe me nënartikujt pëtkatës ku janë bërë shpenzimet faktike sipas programeve buxhetore .

**ANEKSI 4:** Të dhënat e aneksit 4-tatër sipas formularit përkatës bashkangjitur , treguesit e performancës të ndara sipas programeve buxhetore .

**ANEKSI 5 paraqet projektet e investimeve të realizuar me fondet e brendëshme dhe ato të huaja të listuara sipas objekteve të prokurimit .**

**Gjithashtu bashkalidhur materialit është dhe realizimi I regjistrit të prokurimeve publike për vitin 2020 , të gjitha shpenzimet e bëra nga Bashkia Kolonjë ne vitin 2020.**

**Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020 Bashkia Kolonjë ka menaxhur në menyrë më të mirë të mundëshme situatën e pandemisë duke organizuar grupet e patronazhimit me punonjësit e saj të cilët u shërbenin katerorive të moshuara dhe atyrë të pamindurit , si dhe ka përballuar disinfektimin në të gjithë teritorin e saj .**

**Shumicën e punëve dhe shërbimeve bashkia e ka përballuar me punonjësit e saj duke kursyer fondet për këto shërbime dhe duke përdorur me efektivitet shpenzimet e këtij institucioni .**

**Besojmë se në vitin 2021 do të bëhen punë dhe shërbime dhe më të mira se në vitin 2020.**

Përgatiti materialin  
Sofika Rexhepi  
Drejtorja e Financës

**Kryetari i Bashkisë**

**Erion ISAI**

